ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: *Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" SH.A*

Për Aktivitetin e Prokurimit: *70433736-26-2659-1-2-1*

Sa i përket tenderit për: *Furnizim me uniforma dhe veshmbathje për punëtorët e KRU Prishtina sh.a*

ANKESË

SOLID SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Zona Industriale Shirokë, p.n.,
(Adresa)

Suharekë — *23000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/113393 — *n/a*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Shefqet Kuçi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
solidshpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

25.11.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Furnizim me uniforma dhe veshmbathje për punëtorët e KRU Prishtina sh.a

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Hapja e tenderëve është bërë në mënyrë elektronike përmes platformës e-Prokurimi më 19.05.2026, ora 13:00. Sipas Njoftimit mbi Vendimin, në Lotin 2 kanë ofertuar: Solid SH.P.K. (20,887.50 €), Naim Shuki B.I. (21,750.00 €), "Sankos" Sh.p.k. (23,375.00 €), PROGLOBAL SH.P.K. (24,898.25 €) dhe "RIMI-ALTEX" SH.P.K. (24,925.00 €).

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Më 09.11.2026, SOLID ShPK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 02.11.2026, në pjesën që i përket Lotit 2.

Me Vendimin e datës 16.11.2026, të pranuar nga Ankuesi më, AK e ka cilësuar kërkesën të pabazuar dhe i ka qëndruar pranë vendimit të 02.11.2026. Kopja e vendimit bashkëngjitet kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar (LPP):

- Neni 6 – Ekonomia dhe efikasiteti;
- Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi;
- Neni 28 – Specifikimet teknike (pranimi i zgjidhjeve ekuivalente);
- Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve; Neni 54 – Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar; Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;
- Neni 108/A – Shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtim nga autoriteti kontraktues.

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024:

- Neni 38 – Sqarimi i tenderëve;
- Neni– Vlerësimi sipas kërkesave të përcaktuara;
- Neni 42 – Njoftimi dhe arsyetimi i vendimit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

1. Me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 02.11.2026 (në tekstin e mëtejmë: "**Vendimi i kundërshtuar**"), AK e ka eliminuar ofertën e SOLID ShPK (në tekstin e mëtejmë: "**Ankuesi**"). Kjo është oferta më e lirë në Lotin 2, me çmim 20,887.50 Euro. Me të njëjtin vendim, Autoriteti Kontraktues e ka rekomanduar për kontratë PROGLOBAL SH.P.K. (në tekstin e mëtejmë: "**I rekomanduari**"), me çmim 24,898.25 Euro, më shumë. Ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim më 09.11.2026. Me Vendimin e datës 16.11.2026, Autoriteti Kontraktues e cilësoi kërkesën të pabazuar, pa u marrë në thelb me asnjërin prej pretendimeve të saj duke e refuzuar vendimin me një arsyetim të përgjithësuar.

2. Vendimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm për tri arsye kryesore, të cilave u shtohet mosarsyetimi i vendimit për kërkesën për rishqyrtim:

   a) Arsyet e eliminimit të Ankuesit nuk mbështeten në kërkesat e DT-së. Ato përmbajnë kritere që nuk ekzistojnë në Dosje të Tenderit, ose kritere të cilat Dosja e Tebderut i lejon me ekuivalencë.

   b) Dokumentacioni i ofertës së të rekomanduarit nuk dëshmon përmbushjen e të gjitha kërkesave të Aneksit 1 për katër pozicionet e Lotit 2 dhe paraqet mospërputhjet e identifikuara më poshtë. AK nuk ka bazë ta konsiderojë këtë ofertë të përgjegjshme pa shqyrtuar meritorisht pretendimet ankimore të Ankuesit.

   c) AK ka zbatuar standarde të ndryshme për operatorët ekonomikë. Ankuesin e ka eliminuar për mangësi, kurse të rekomanduarin e ka pranuar edhe pse ka të njëjtat mangësi, madje edhe më të rënda në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

   d) Në Vendimin e 16.11.2026, AK nuk i ka shqyrtuar në thelb pretendimet e kërkesës për rishqyrtim, në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së (shih pjesën V).

II. ARSYET E ELIMINIMIT TË ANKUESIT JANË TË PABAZUARA

3. Në këtë aktivitet prokurimi, AK vetë e ka vlerësuar ofertën e SOLID ShPK dhe e ka shpallur atë të përgjegjshme në dy raste të mëparshme. Oferta e vlerësuar është po ajo që është dorëzuar më 19.05.2026 dhe nuk ka mundur të ndryshojë pas afatit të dorëzimit. Megjithatë, me Vendimin e kundërshtuar AK e eliminon të njëjtën ofertë, pa shpjeguar se cili fakt ose cila provë e re e ka ndryshuar vlerësimin e saj të mëparshëm. Për më tepër, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar AK nuk e ka sqaruar se për cilin nga artikujt rendorë 1 deri në 4 Ankuesi nuk i ka plotësuar kërkesat. Arsyet renditen në mënyrë të përgjithshme dhe të ngatërruar.

   Në Vendimin e 16.11.2026, AK nuk e shpjegon as tani pse e ka ndryshuar vlerësimin e mëparshëm. Për nenin 54 të LPP-së dhe nenin 42 të Rregullores, ajo përgjigjet vetëm se "ka njoftuar palët" me publikimin e njoftimit B58. Pretendimi i Ankuesit nuk ishte se njoftimi nuk është publikuar, por se ai nuk është i arsyetuar.

4. Letra e eliminimit i grupon arsyet (ii), (iii) dhe (iv) nën "pika 2" (çizme sigurie gome). Megjithatë, trashësia 0,7 mm, pesha 685–700 g/m², rezistenca në −30 °C dhe standardi EN ISO 13688 janë kërkesa të pozicionit 3 (çizme peshkatari), jo të pozicionit 2. Për pozicionin 2 këto kërkesa nuk ekzistojnë fare në Aneksin 1. Për më tepër, AK e citon gabim kërkesën e DT-së si "685 g/m² ± 70 g/m²", ndërsa DT kërkon "min. 685 gr/m²–700 gr/m²". AK duhej të identifikonte saktë artikullin, parametrin dhe dokumentin e

ofertës mbi të cilin mbështetet secila arsye eliminimi, sipas nenit 54 të LPP-së dhe nenit 42.3 të Rregullores. Edhe nëse bëhet fjalë vetëm për gabim në numërtim, gabimi nuk e zëvendëson shqyrtimin e përmbushjes së kërkesës. AK nuk është përgjigjur fare për këtë pretendim në Vendimin e 16.11.2026.

5. Sipas klasifikimit të EN ISO 20345:2011, S3 zbatohet për këpucë të Klasës I, prej lëkure dhe materialesh të tjera, ndërsa S4/S5 për këpucë të Klasës II, tërësisht prej gome ose polimeri. S5 përfshin mbrojtjen e gishtave, antistaticitetin, absorbimin e energjisë në thembër, rezistencën e shputës ndaj karburanteve dhe shpimit, si dhe shputën me reliev. Aneksi 1 kërkon "çizme sigurie gome" dhe lejon shprehimisht standarde ekuivalente. Prandaj, shënimi S5, më vete, nuk është arsye e mjaftueshme për eliminim: AK duhej të krahasonte vetitë e dëshmuara të produktit me kërkesat funksionale të DT-së, sipas nenit 28 të LPP-së.

6. Sqarimi i AK-së i datës 08.05.2026 për çizmet e sigurisë prej gome (arsyeja i). Arsyeja (i) bie ndesh me Përgjigjen e AK-së në pyetjet e operatorëve ekonomikë, të publikuar më 08.05.2026, ora 14:27, e cila e ka plotësuar dhe ndryshuar DT-në. Një operator ekonomik pyeti nëse, për artikullin "Çizme sigurie gome", në vend të standardeve DIN 32768, EN 343, ISO 22196, ISO 20743 dhe nivelit S3 sipas EN 20345:2021, mund të zbatohet standardi EN ISO 20345:2022+A1:2024, me nivel mbrojtjeje S5 FO SR. AK u përgjigj: "*Ne artikullin- Çizme sigurie gome eshte cekur ne specifikim: ekuivalent me standardet tjera. Standardi EN343, ISO22196, ISO 2743 eshte adoptuar dhe zevendesuar me EN ISO 20345:2021 dhe EN ISO 20345:2022, keshtu qe mund te zevendesohet*." Pra, AK e ka pranuar paraprakisht dhe publikisht zgjidhjen S5 sipas EN ISO 20345:2022. Sqarimi i publikuar i detyron njëlloj të gjithë ofertuesit dhe vetë AK-në gjatë vlerësimit. Eliminimi i Ankuesit pikërisht sepse ka ofertuar S5 në vend të S3 e kundërshton këtë sqarim dhe cenon besimin legjitim të ofertuesve që u mbështetën në të. Për këtë pozicion Ankuesi ka ofertuar çizme sigurie prej gome S5, modeli HERCULES, dhe ka dorëzuar: (a) katalogun e prodhuesit ("HERCULES_BLK_en"); (b) Deklaratën e Konformitetit të BE-së sipas Rregullores (BE) 2016/425 ("DOC_HERCULES_EN"); dhe (c) Certifikatën e Ekzaminimit të Tipit të BE-së, Moduli B, nr. 0598/PPE/24/2271, Issue 3 ("HERCULES ARTEMIS APOLLO-M1546_CE_DSS_0598_PPE_24_2271 Issue 3-2024 SGS").

   Në Vendimin e 16.11.2026, AK nuk e përmend fare sqarimin e 08.05.2026. Për nenin 28 të LPP-së, ajo përgjigjet vetëm se gjatë afatit të tenderit nuk ka pranuar kërkesë për rishqyrtim apo ankesë kundër specifikimeve teknike. Kjo nuk ka lidhje me pretendimin, pasi që Ankuesi nuk i ka kontestuar specifikimet, por zbatimin e tyre gjatë vlerësimit, në kundërshtim me klauzolën e ekuivalencës dhe me sqarimin e vetë AK-së. Pikërisht sepse Ankuesi i pranoi specifikimet ashtu siç ishin formuluar dhe sqaruar, ai ka të drejtë të vlerësohet sipas tyre.

7. Për më tepër, i rekomanduari ka ofertuar për të njëjtin pozicion çizme të nivelit S5: Exena "DEVIL BLACK S5 SRC". Në ofertën e tij gjendet edhe certifikata CIMAC nr. F-130-08544-25, klasa "S5 FO SR", por për artikullin "DEVIL 24"; lidhja e saj me modelin "DEVIL BLACK" nuk është sqaruar. Oferta e tij është pranuar si e përgjegjshme. Nëse arsyeja e eliminimit të Ankuesit është klasa S5, pranimi i së njëjtës klasë te i rekomanduari përbën trajtim të pabarabartë.

8. Pozicioni 3 – trashësia, pesha dhe rezistenca nën −30 °C (arsyeja ii). Përmbushja e këtyre parametrave duhet vlerësuar nga dokumentacioni i prodhuesit për modelin e

ofertuar dhe nga mostra e dorëzuar, sipas mënyrës së dëshmimit të kërkuar në DT. AK duhet të zbatojë të njëjtin standard verifikimi ndaj të dy ofertuesve. Katalogu i të rekomanduarit për çizmet e peshkatarit, PROS “Chest waders STANDARD SB01” (f. 33–34), nuk jep trashësinë dhe peshën për m², ndonëse deklaron qëndrueshmëri të materialit në përkulje deri në −50 °C. Pranimi i tij pa dëshmuar dy parametrat numerikë, ndërkohë që Ankuesi eliminohet për mosdëshmimin e tyre, përbën trajtim të pabarabartë.

9. EN ISO 13688 (arsyeja iii). Standardi përcakton kërkesat e përgjithshme për veshjet mbrojtëse. AK duhet të vlerësojë nëse deklarata e konformitetit ose certifikata e prodhuesit për modelin konkret e përfshin këtë standard. DT e pranon shprehimisht deklaratën e konformitetit si formë dëshmie. Në rast paqartësie dokumentare duhet zbatuar mundësia e sqarimit nenit 38 të Rregullores, pa ndryshuar produktin ose karakteristikat materiale të ofertës. Për më tepër, në Përgjigjen e 08.05.2026 (pika 3), AK ka konfirmuar se edhe për çizmet e peshkatarit specifikimi lejon standarde ekuivalente dhe se, në përdorim industrial ose për punë të rënda, këto çizme zakonisht përforcohen me çizme sigurie të klasës S5. Rrjedhimisht, mungesa e referimit të veçantë në EN ISO 13688 nuk mund të jetë shkak eliminimi kur produkti dëshmon përputhshmëri me standard ekuivalent ose më të lartë.

10. Mungesa e një dokumenti me emërtimin "Test Report" (arsyeja iv). Aneksi 1 lejon certifikata, deklarata konformiteti ose etiketën e prodhuesit me të dhënat përkatëse, ndërsa FDT 9.1, Kërkesa 1, kërkon dokumentacion të prodhuesit nga i cili verifikohen të gjitha specifikimet teknike. Për pozicionin 2, DT kërkon shprehimisht veti antibakteriale dhe mbrojtje nga myku e substancat mikrobiologjike sipas ISO 22196 dhe ISO 20743, të testuara sipas AATCC 30. Kundërshtimi i Ankuesit lidhet me imponimin e një forme dokumenti të papërcaktuar në DT, jo me heqjen e detyrimit për të dëshmuar këto teste dhe veti. Nëse certifikata ose deklarata e prodhuesit i mbulon ato për modelin e ofertuar, mungesa e një raporti të veçantë nuk mjafton vetvetiu për eliminim. Nëse nuk i mbulon, kjo kërkon verifikim sipas të njëjtit standard për secilin ofertues. Edhe te i rekomanduari, fleta teknike në f. 32 paraqet rezultate për veti mekanike, por nuk dëshmon testet specifike antibakteriale dhe kundër mykut. Shtimi i një kriteri të ri dokumentar ose heqja e një kërkese materiale bie ndesh me nenin 59 të LPP-së dhe nenet 40.2 dhe 40.12 të Rregullores. Në Vendimin e 16.11.2026, AK e përshkruan vetë nenin 40.12 të Rregullores si “moseliminim nga procedura të OE në bazë të kritereve apo kërkesave që nuk kanë qenë në DT” dhe përfundon se “ka zbatuar të gjitha këto rekomandime”. AK nuk tregon se ku në DT kërkohet një dokument i veçantë “Test Report”.

11. Pozicioni 1 – oferta e Ankuesit. Për pozicionin 1 Ankuesi ka ofertuar modelin BESTBOY S3 Steel Toe Safety Shoes Mid. Përmbushja e kërkesave dëshmohet me dokumentet e dorëzuara në dosjen “10. Certifikatat katalog etj.” (a) katalogu i prodhuesit (“BESTBOY BLK”); (b) Certifikata e Ekzaminimit të Tipit të BE-së sipas Rregullores (BE) 2016/425, Moduli B, nr. 0598/PPE/23/2780, Issue 2 (“BESTRUN BESTBOY-M1159-LG_CE_DSS_0598_PPE_23_2780 Issue 2-2024 SGS”); dhe (c) Deklarata e Konformitetit të BE-së (“DOC_BESTBOY_EN”). Këto dokumente dëshmojnë se produkti i ofruar i përmbush kërkesat e AK-së për pozicionin 1. AK nuk ka treguar cilën veti konkrete nga S3, FO, SR, WPA, CI dhe HI e konsideron të padëshmuar, as në cilin prej këtyre dokumenteve e mbështet këtë përfundim.

12. Pozicioni 1 – S3, FO, SR, WPA, CI dhe HI. Aneksi 1 i DT-së referon “EN 20345 S3 FO SR WPA CI HI”, pa përcaktuar në këtë rresht vitin 2021, dhe lejon standarde ekuivalente. ISO 20345:2021 ekziston si standard ndërkombëtar, ndërsa miratimi evropian përkatës është EN ISO 20345:2022. Prandaj, vlerësimi duhet të mbështetet te vetitë e kërkuara dhe ekuivalenca e dëshmuar, jo vetëm te ndryshimi i vitit ose i shkurtesave ndërmjet botimeve. I rekomanduari ka paraqitur NAPRON AS-8000 me deklaratë konformiteti të vitit 2018 sipas EN ISO 20345:2011, klasa “S3 WR CI SRC”. Në këto dokumente nuk dëshmohet HI ose vetia antibakteriale. AK duhet ta arsyetojë këtë krahasim në mënyrë të njëjtë për të dy ofertuesit.

13. Pozicioni 3 – pretendimi “mungon katalogu”. Katalogu i çizmeve të peshkatarit gjendet brenda dokumenteve të dorëzuara me ofertën e Ankuesit, prandaj konstatimi i AK-së se ai nuk është dorëzuar është faktikisht i gabuar. Në çdo rast, AK duhej të identifikonte dokumentet e shqyrtuara dhe të vlerësonte nëse katalogu, manuali ose broshura e prodhuesit për modelin konkret është përfshirë në ofertë. Nëse kishte paqartësi ose dokumentacion të plotësueshëm, neni 72 i LPP-së dhe neni 38 i Rregullores lejojnë sqarimin ose plotësimin me prova që pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para afatit për dorëzimin e tenderëve. AK nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi, por e ka eliminuar menjëherë ofertën më të lirë.

    Në Vendimin e 16.11.2026, AK pohon se e ka zbatuar nenin 72 të LPP-së dhe nenin 38 të Rregullores, duke i kërkuar Ankuesit sqarime më 08.07.2026 dhe 14.10.2026. AK nuk tregon çfarë ka kërkuar, çfarë është përgjigjur Ankuesi dhe pse përgjigjet u konsideruan të pamjaftueshme. Pas këtyre sqarimeve, AK e ka shpallur ofertën e Ankuesit të përgjegjshme (pika 3), prandaj ato nuk mund të shërbejnë si bazë për eliminimin e mëvonshëm të së njëjtës ofertë pa asnjë provë të re. Sqarimet nuk i kanë adresuar as arsyet vendimtare të Vendimit të kundërshtuar: klasën S5 të pranuar me Përgjigjen e 08.05.2026, ngatërrimin e pozicioneve 2 dhe 3, kërkesën për "Test Report" dhe pretendimin për mungesën e katalogut.

III. OFERTA E TË REKOMANDUARIT NUK I PËRMBUSH KËRKESAT E DOSJES SË TENDERIT

14. FDT 9.1, Kërkesa 1, kërkon katalogë “të lëshuara nga prodhuesi, nga të cilat mund të verifikohen të gjitha të dhënat teknike (specifikacioni) të kërkuara në Aneksin 1”. IT 3.2 përcakton se “cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikojë tenderin”. Sipas dokumenteve të ofertës së të rekomanduarit (“2. Proglobal – Catalog & EN Certificate”, 38 faqe), për secilin nga katër pozicionet identifikohen mangësi në dëshmimin e kërkesave ose mospërputhje të produktit, si më poshtë. Për asnjërën prej tyre AK nuk ka dhënë përgjigje në Vendimin e 16.11.2026, përveç pohimit të përgjithshëm se “ka respektuar kërkesat” e Aneksit 1.

15. Pozicioni 1 – Këpucë të thella S3 (Napron AS-8000, Akyüz İş Ayakkabıları A.Ş.):

    – Nuk është dëshmuar kërkesa “Këpucët duhet të jenë prodhim Europian”. Dokumentacioni identifikon prodhuesin në Çayırova/Kocaeli, Türkiye, në pjesën aziatike të Turqisë, dhe katalogu mban shënimin "Turkey". Oferta nuk përmban asnjë dëshmi se modeli AS-8000 prodhohet në Evropë.
    – Nuk dëshmohet HI (izolim ndaj nxehtësisë), as vetia antibakteriale. Asnjëra nuk përmendet në katalog apo në deklaratën e konformitetit.

- Për AS-8000 është dorëzuar deklarata e prodhuesit e vitit 2018 sipas EN ISO 20345:2011, e cila vetëm përmend certifikatën nr. 2163-PPE-988, datë 30.11.2018; vetë certifikata dhe dëshmia e ripërtëritjes nuk janë bashkëngjitur. Aneksi V, pika 6, i Rregullores (BE) 2016/425 kufizon vlefshmërinë e certifikatës së ekzaminimit të tipit në jo më shumë se pesë vjet, prandaj dokumenti i vitit 2018 nuk dëshmon certifikim të vlefshëm në datën e ofertimit. Deklarata shënon "Kategoria I" dhe njëkohësisht përmend ekzaminimin e tipit, Modul B, gjë që kërkon sqarim.
- Nuk dëshmohet paketimi veç e veç i secilës palë në kuti nga letra e fortë, katalogu tregon vetëm "10 palë në kuti". AK duhet të verifikojë paketimin dhe etiketën e mostrës dhe ta dokumentojë rezultatin.

16. Pozicioni 2 – Çizme sigurie gome (Exena DEVIL BLACK S5 SRC):
    - Materiali në f. 24 dhe 32 përshkruhet si përzierje "PVC – 8% Nitrilic rubber", që kërkon krahasim me materialin dhe funksionin e kërkuar për "çizme sigurie gome".
    - Mungon tërësisht dëshmia për vetinë antibakteriale sipas ISO 22196 dhe ISO 20743, të testuar sipas metodës AATCC 30, e cila kërkohet shprehimisht në Aneksin 1.
    - Katalogu përmban vendmbajtës redaktimi, si "COVER" dhe "RETRO COPERTINA DA ULTIMARE" (f. 21–27). Modeli i shënuar në f. 25 është "DEVIL BLACK S5 SRC", ndërsa certifikata CIMAC nr. F-130-08544-25 në f. 28–31 emërton "DEVIL 24". Dokumentet nuk shpjegojnë lidhjen ndërmjet modeleve dhe mbulimin e produktit të ofertuar nga kjo certifikatë.
    - Niveli i ofertuar është S5, pra po ai nivel për të cilin u eliminua Ankuesi (shih pikën 7).
17. Pozicioni 3 – Çizme peshkatari (PROS SB01, AJ Group, Poloni):
    - Nuk jepet trashësia e materialit (min. 0,7 mm), as pesha (685–700 g/m²). Pikërisht këto u përdorën si arsye për eliminimin e Ankuesit.
    - Deklarata në f. 35 përshkruan "PVC boot with functions O4 FO SR", ndërsa DT kërkon "gomë të vullkanizuar". Deklarata i përket varianteve STRONG/SBP01 dhe nuk është lidhur qartë me STANDARD SB01 në katalog.
    - Ka mospërputhje modeli: katalogu (f. 33) tregon modelin "STANDARD SB01" me klasë "EN ISO 20347 – OB SRC", ndërsa deklarata e konformitetit (f. 35) mbulon modelet "SB 01 STRONG, SBP 01 – O4 FO SR". Nuk dihet cili model është ofertuar dhe a e mbulon dokumenti i konformitetit modelin e ofertuar.
18. **Pozicioni 4 – Kllompe (LEON V202, PTP Leon d.o.o., Serbi):**
    - Nuk dëshmohet vetia antistatike. Certifikata BIMEO nr. EU-0863-L/2025, 1. addition (f. 38), jep klasën "OB SRC E", pa klasifikimin "A"; shënimi "E" dëshmon absorbimin e energjisë në thembër, jo vetinë antistatike.
    - Nuk dëshmohet rezistenca ndaj vajrave: në certifikatë dhe në përshkrimin e dorëzuar nuk identifikohet FO ose provë tjetër për këtë veti.
    - Nuk janë të papërshkueshme nga uji, pjesa e sipërme është lëkurë e perforuar ("prirodna koža s perforacijama", f. 36), pra e kundërta e kërkesës.
    - Certifikata mbulon EN ISO 20347:2012, ndërsa Aneksi 1 referon EN ISO 20347:2021, dhe në ofertë nuk është paraqitur krahasim që dëshmon barasvlershmërinë sipas nenit 28 të LPP-së.

– Faqet 36–37 janë printim nga faqja e një shitësi me pakicë, me tekst në kroatisht, dhe jo katalog, manual ose broshurë e lëshuar nga prodhuesi, siç kërkon FDT 9.1.

19. Deklarata e të rekomanduarit se "oferta jonë është në përputhje të plotë me Aneksin 1" nuk e zëvendëson dokumentacionin e prodhuesit të kërkuar me FDT 9.1 dhe nuk mënjanon kundërshtimet që dalin nga karakteristikat e produktit. Duhet dalluar mungesa e një prove të plotësueshme nga mospërputhja materiale e mallit. Sqarimi sipas nenit 38 të Rregullores mund të vërtetojë gjendjen ekzistuese para afatit të ofertimit për modelin tashmë të ofertuar. Neni nuk lejon zëvendësimin e modelit ose ndryshimin e karakteristikave të tij për ta bërë ofertën të përgjegjshme.

IV. SHKELJA E PARIMIT TË BARAZISË NË TRAJTIM

20. AK e ka eliminuar Ankuesin, sipas arsyeve të kundërshtuara më sipër, për klasën S5, mosdëshmimin e trashësisë dhe peshës, mungesën e raportit të testimit dhe mosdëshmimin e klasave të plota të këpucëve. Ndërkohë, ka pranuar te i rekomanduari klasën S5, katalog pa trashësi dhe gramaturë për çizmet e peshkatarit, dokumentacion pa testet specifike antibakteriale dhe kundër mykut, si dhe deklaratë të AS-8000 ku nuk dëshmohet HI:

Kërkesa	**Ankuesi (SOLID ShPK)**	**I rekomanduari (PROGLOBAL)**
Pozicioni 2 – çizme sigurie gome të klasës S5	Eliminuar (arsyeja i)	Pranuar (DEVIL BLACK S5 SRC)
Pozicioni 3 – trashësia dhe pesha e materialit	Eliminuar (arsyeja ii)	Pranuar pa këto të dhëna (PROS SB01)
Vetia antibakteriale / testet (ISO 22196, ISO 20743)	Eliminuar për mungesë "Test Report" (arsyeja iv)	Pranuar pa këto teste (f. 32)
Pozicioni 1 – klasat e plota, përfshirë HI	Eliminuar pa u specifikuar vetia	Pranuar (AS-8000, pa HI)

Zbatimi në mënyrë të ndryshme i kërkesave të njëjta materiale shkel nenin 7 të LPP-së. Pasoja e duhur është rivlerësimi i njëtrajtshëm dhe i arsyetuar. Përgjigja e AK-së, se "ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe transparente të gjithë OE", nuk shpjegon asnjërin prej këtyre dallimeve.

21. Oferta e rekomanduar është 4,010.75 Euro më e shtrenjtë se oferta e Ankuesit. Kjo diferencë e bën të nevojshëm shqyrtimin e plotë të ligjshmërisë së eliminimit dhe zbatimin e nenit 6 të LPP-së. Përgjigja e AK-së, se kontrata u propozua për "OE të përgjegjshëm me çmimin më të lirë", e merr si të provuar pikërisht atë që kontestohet: përgjegjshmërinë e dy ofertave.

V. VENDIMI I AK-SË I DATËS 16.11.2026 DHE AFATSHMËRIA E ANKESËS

22. Vendimi i 16.11.2026 nuk i shqyrton pretendimet e kërkesës për rishqyrtim. Për secilën dispozitë të cituar, AK e përshkruan përmbajtjen e përgjithshme të nenit dhe përfundon se "vlerëson se ka respektuar" atë, "prandaj cileson këtë pretendim të pabazuar". Për pikat 4–21 AK përgjigjet me një fjali të vetme: se Komisioni "nuk ka pranuar rishqyrtimin e vendimit të vet" dhe "i qëndron pranë". Neni 108/A i LPP-së e ngarkon AK-në ta shqyrtojë kërkesën dhe të vendosë për të, në mënyrë që mosmarrëveshja të

zgjidhet para se të arrijë te OSHP. Kjo nënkupton përgjigje në thelb ndaj secilit pretendim. Mosarsyetimi shkel dispozitat e transparencës neni 7 i LPP-së, nenin 54 të LPP-së dhe nenin 42.3 të Rregullores, dhe i lë pretendimet faktike të Ankuesit të pakontestuara në thelb, si e tillë bie ndesh edhe me kërkesat e LPPA për arsyetimin e aktit administrativ.

24. Duke pasur parasysh natyrën teknike të kontestit, Ankuesi i propozon OSHP-së të caktojë ekspert teknik krahas ati shqyrtues për verifikimin e ofertave të SOLID ShPK dhe PROGLOBAL SH.P.K. në Lotin 2, në raport me Aneksin 1, FDT 9.1 dhe Përgjigjen e AK-së të 08.05.2026.

Duke u bazuar në sa më sipër, Ankuesi i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së që të nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik SOLID ShPK.

II. **ANULOHEN** Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 16.11.2026 për kërkesën për rishqyrtim dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 02.11.2026, në pjesën që i përket Lotit 2, përfshirë eliminimin e SOLID ShPK dhe rekomandimin për dhënie të kontratës PROGLOBAL SH.P.K. dhe lënda i kthehet AK në **RIVLERËSIM**.

III. **I KTHEHET** tarifa e ankesës Ankuesit, sipas nenit 118 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*